



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 6.1 dhe 52 të Rregullores së Kuvendit, në seancën plenare e mbajtur më 16 maj 2019, me propozim të Komisionit ad hoc, i formuar me vendim të Kuvendit më 15.04.2019, për hartimin e Projekt-rezolutës për gjenocidin e kryer serb në Kosovë, miraton këtë:

REZOLUTË
për gjenocidin e kryer serb në Kosovë

Duke pasur parasysh:

- Kartën e Kombeve të Bashkuara, 24 tetor 1945;
- Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut të OKB, 10 dhjetor 1948;
- Deklaratën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB në Rezolutën 96 (I), 11 dhjetor 1946, që gjenocidin e kualifikon krim sipas të drejtës ndërkombëtare që është në kundërshtim me frymën dhe qëllimin e Kombeve të Bashkuara dhe i dënueshëm nga bota e qytetëruar;
- Konventën për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit, 9 dhjetor 1948;
- Konventat e Gjenevës të vitit 1949, sidomos Konventës së IV për mbrojtjen e Personave Civil në kohë Lufte, si dhe Protokollet Shtesë I dhe II të vitit 1977;
- Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politik, 16 dhjetor 1966;
- Statutin e Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale, 17 korrik 1998, për dënimin e krimit të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës;
- Konventën e OKB për Moszbatimin e Kufizimeve Ligjore për Krimet e Luftës dhe Krimet kundër Njerëzimit, 26 nëntor 1968, pa marrë parasysh kohën e kryerjes së tyre, për të gjitha krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit të kryera në kohë lufte apo paqe, të definuara në Kartën e Tribunalit Ushtarak të Nyrnbergut, datë 8 gusht 1945, të konfirmuara me Rezolutat 3(I) të datës 13 shkurt 1946 dhe 95(I) të datës 11 dhjetor 1946 të Asamblesë së

Përgjithshme të OKB, sidomos “shkeljet e rënda” të listuara në Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949, për mbrojtjen e viktimave të luftës; dëbimin me sulme të armatosura apo pushtimin si dhe aktet johumane si pasojë e politikës së apartheidit, dhe krimin e gjenocidit të definuar sipas Konventës së vitit 1948 për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit, madje edhe nëse aktet e tillë nuk përbëjnë shkelje të së drejtës së vendit në të cilin janë kryer ato.

- Rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme të OKB: A/HRC/RES/37/26, 23 mars 2018; A/HRC/RES/7/25, 28 mars 2008; A/HRC/RES/22/22, 22 mars 2013; A/HRC/RES/28/34, 27 mars 2015, për parandalimin e krimit të gjenocidit, që kërkojnë intensifikimin e përpjekjeve institucionale shtetërore, sidomos në sistemin e drejtësisë, për identifikimin, ndjekjen dhe gjykimin e veprimeve që mund të shpien drejt krimit të gjenocidit.

Duke u referuar në:

- Raportin e Reporterit Special të OKB A/53/322 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB të datës 11.09.1998, për vrasjet dhe ekzekutimet arbitrale të banorëve shqiptarë në vendbanimet e tyre dhe numrin e madh të të dëbuarve, shkatërrimit të vendbanimeve shqiptare nga artileria ushtarake e Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ - Serbia dhe Mali i Zi), sidomos ajo serbe dhe të djegura e shkatëruara nga operacionet post-militare të qëllimshme;
- Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB A/53/556, të datës 30.10.1998; S/1998/912, të datës 3 tetor 1998; S/1999/293, të datës 17 mars 1999, për vrasjen e mijëra civilëve shqiptarë, kryesisht fëmijë, gra dhe të moshuar, për dëbimin e rreth 1 milion shqiptarëve nga shtëpitë dhe vendbanimet e tyre, prej të cilëve mbi 800'000 në vendet fqinje; me mbi 100'000 shtëpi dhe objekte, nga to mbi 900 shkolla tërësisht të shkatëruara, të dëmtuara apo të djegura, “Me një shkallë të shkatërrimit që dëshmon qartazi për një përdorim të forcës jodiskriminuese dhe joproportionalë kundër popullatës civile”, me qëllim që të “çrrënjosin grupe të kosovarëve duke bllokuar çdo përpjekje për ndihma”; dhe thirrjen për angazhimin e komunitetit ndërkombëtar për mbledhjen dhe sigurimin e burimeve për ndihmë humanitare si përgjigje në Apelin për ndihmë humanitare të Agjencionit të Konsoliduar të OKB për krizën në Kosovë;
- Deklaratën e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB në Sesionin e 53-të të Komisionit për të Drejtat e Njeriut të OKB, E/CN.4/1999/SR.19, 9 korrik 1999, për fundshekullin e 20-të “nën retë e zeza të gjenocidit” me “shpërthime të dhunës jodiskriminuese dhe vrasje të organizuara masive”, e që karakterizohet edhe me “Fushatën e spastrimit etnik të kryer nga autoritetet serbe në Kosovë, që duket se ka vetëm një qëllim: të dëbojë nga Kosova ose të vrasë sa më shumë shqiptarë etnikë, duke i mohuar një populli të drejtat themelore për jetën, lirinë dhe sigurinë.”;

- Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB 1168 (1998), 31 mars 1998; 1999 (1998), 23 shtator 1998; 1203 (1998), 24 tetor 1998; 1239 (1999), 14 maj 1999; dhe 1244 (1999), 10 qershor 1999 në lidhje krimet e kryera në Kosovë nga forcat ushtarake të RFJ (Serbia dhe Mali i Zi), sidomos të Serbisë dhe gjendjen e rëndë humanitare të refugjatëve shqiptarë brenda Kosovës dhe në vendet fqinje;
- Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB S/RES/1820 (2008), 19 qershor 2008, që thekson se “përdhunimi dhe format e tjera të dhunës seksuale mund të përbëjnë krim të luftës, krim kundër njerëzimit, apo dhe akt konstituiv të gjenocidit”, dhe kërkon përjashtimin e dhunës seksuale nga dispozitat për amnisti në kontekstin e proceseve për zgjidhjen e konflikteve;
- Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB S/RES/2467 (2019), 23 prill 2019, për përgjegjësinë e shteteve për t'i dhënë fund mosndëshkimit dhe përndjekjes penale përgjegjësve për krime të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës, të kryera kundër civilëve, duke theksuar shqetësimin se vetëm një numër shumë i kufizuar i autorëve të dhunës seksuale sillen para drejtësisë;
- Rezolutën 47/121 të Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, 18 dhjetor 1992, në të cilën theksohet qartë se dëbimi masiv nga shtëpitë e veta të civilëve të pambrojtur dhe zbatimi i politikës së spastrimit etnik është një formë gjenocidi;
- Deklaratën dhe Planin Aksional të Konferencës Botërore të të Drejtave të Njeriut të organizuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në Vjenë, 25 qershor 1993, sidomos paragrafi 28, që thekson se praktika shkeljeve masive të të drejtave të njeriut në format e gjenocidit, ‘spastrimit etnik’ dhe përdhunimit sistematik të grave në situata lufte, si dhe eksodi masiv i njerëzve nga vendbanimet dhe vendi i tyre, janë të pafalshme dhe të dënueshme në çdo kohë;
- Rekomandimin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës 1403 (1999), 28 prill 1999 si dhe Rezolutën 1182 (1999), 30 mars 1999 për krizën e refugjatëve brenda në Kosovë dhe nga Kosova në vendet fqinje Shqipëri, Maqedoni dhe Mali i Zi, për rrezikun e refugjatëve të rrezikuar nga vrasjet dhe vdekja.

Duke u nisur nga faktet se:

- Viti 2019 shënon 20 vjetorin e Luftës në Kosovë dhe krimet e kryera nga forcat e armatosura të RFJ (Serbia dhe Mali i Zi), sidomos ato serbe, të fushatës së programuar, planifikuar dhe të institucionalizuar shtetërore, me qëllimin shfarosjen e shqiptarëve dhe ndryshimin e dhunshëm të përbërjes etnike të Kosovës, duke dëbuar rreth 1 Milion persona, duke vrarë rreth 12 mijë civilë të pambrojtur të të gjitha etnive boshnjakë, turq, romë, ashkali, egjiptian, dhe sidomos e kryesisht shqiptarë, në mesin e të cilëve 1392 fëmijë, mbi 800 prej tyre nën moshën 5 vjeçare dhe 1739 gra;

- Gjatë periudhës 1998-1999, forcat serbe kryen në Kosovë rrëth 100 masakra kolektive të evidentuara ndaj popullsisë të pambrojtur civile në Kosovë, kryesisht shqiptarë, me shkatërrime të vendbanimeve dhe shtëpive, duke vrarë në mënyrë mizore fëmijë, gra dhe të moshuar, madje duke i djegur të gjallë në prani të tjerëve, si në: Likoshan, 28 Shkurt - 1 Mars 1998, 24 viktima civile; Qirez 28 Shkurt - 1 Mars 1998, 24 viktima civile; Prekaz 5-7 Mars 1998, 59 viktima civile, 55 të familjes Jashari; Lybeniq, masakra e parë 25 maj 1998, 10 viktima civile; Fortesë (ish Bellacerkë), 18 korrik 1998, 12 viktima civile; Rancë (Shtime) 26 gusht 1998, 11 viktima civile; Kleçkë, 27 gusht 1998, 8 të vrarë dhe mbi 30 të plagosur, viktima civile; Shalë e Bajgorës 15-17 shtator 1998, 12 viktima civile; Çyçavicë 22-24 shtator 1998, 24 viktima civile, 6 të mbytur me çekan në kokë; Gullboc (Malishevë) 26 shtator 1998, 14 viktima civile; Abri e Epërme, 26 Shtator 1998, 24 viktima civile të familjes Delijaj; Lubeniq, masakra e dytë 1 dhe 7 Prill 1999, 100 viktima civile, prej tyre edhe gra shtatzëna dhe fëmijë nga mosha 2 vjeçare; Raçak, 15 Janar 1999, 43 viktima civile; Ura e Rakovinës 24 janar 1999, 4 viktima civile; Leshan i Suharekës, 2 mars 1999, 29 viktima civile; Reznik (Vushtrri) 6 mars 1999, 9 viktima civile të cilat u dogjën; Mitrovicë 13 mars 1999, 6 viktima civile; Tërrnavë (Podujevë) 20 mars 1999, 4 të vrarë dhe 11 të plagosur, viktima civile; Skenderaj, 20 mars 1999, 29 viktima civile; Kotlinë (Kaçanik), 24 Mars 1999, 26 viktima civile; Podujevë, 24 e 25 mars 1999, 36 viktima civile; Celinë, 25 mars 1999, 82 viktima civile; Fortesë (ish Bellacerkë), 25 mars 1999, 46 viktima civile; Goden, 25 mars 1999, 28 viktima civile; Randobravë, 25 mars 1999, 8 viktima civile nga familja Pajaziti; Krushë e Vogël, 26 mars 1999, 113 viktima civile; Krushë e Madhe, 25, 26 dhe 27 mars 1999, 241 viktima civile; Tërrnje (Suharekë), 25 mars 1999, 28 viktima civile; Suharekë, 26 mars 1999, 48 viktima civile, anëtarë të familjes Berisha; Padalishtë, 26 Mars 1999, 19 viktima civile, anëtarë të familjes Imeraj; Landovicë, 26 mars 1999, 23 viktima civile; Mamushë, 27 mars 1999, 18 viktima civile; Dardhishtë (Obiliq), 27 mars 1999, 11 viktima civile nga familja Rama; Gjakovë, 27 mars 1999, 6 viktima civile nga familja Çerkezi; Izbicë, 28 mars 1999, 114 viktima civile; Matiçan (Prishtinë), 28 mars 1999, 21 viktima civile; Podujevë, 28 mars 1999, 19 viktima civile, anëtarë të familjeve Duriqi, Bogujevci, Llugalit dhe Gashi; Beleg (Deçan), 28-29 mars 1999, të vrarë e të zhdukur 46 civilë; Dumnicë e Epërme, 29 mars dhe 11 prill 1999, 6 viktima civile nga granatimi; Mitrovicë, 29 mars 1999, 4 viktima civile; Llashticë e Gjilanit, 30 mars 1999, 22 viktima civile, disa të djegur për së gjalli; Burim (Bellanicë-Malishevë), 31 mars 1999, 34 viktima civile; Pastasel, 31 Mars 1999, 106 viktima civile; Lybeniq (Pejë), 1 prill 1999, 60 viktima civile; Cercë, 1 prill 1999, 6 viktima civile nga familja Rexha; Gjakovë, 2 prill 1999, 6 viktima civile, Nëna me 5 fëmijë të moshës 1988-1997 nga familja Vejsa; Nagac (Rahovec), 2 prill 1999, 31 viktima civile; Sopi, 2 prill 1999, 35 viktima civile; Kralan, 2-4 prill 1999, 100 viktima civile; Prishtinë (Lagja Arbëri), 3 prill 1999, 7 viktima civile; Çupevë e Epërme, 4 prill 1999, 45 viktima civile; Popovë (Podujevë), 4 prill 1999, shumë viktima civile, të gjithë refugjatë të brendshëm; Rezallë, 5 prill 1999, 41 viktima civile; Kokaj (Gjilan), 5 prill 1999, 6 viktima civile; Prroi i Rakocit

dhe Lagja e Re në Kaçanik, 9 prill 1999, 58 viktima civile; Lubizhdë e Hasit, 12 prill 1999, rrreth 18 viktima civile; Fshati i Vjetër (Ferizaj), 13 prill 1999, 7 viktima civile; Mitrovicë, 14 prill 1999, 26 viktima civile; Sllovi dhe Lipjan, 15 e 16 Prill 1999, 41 viktima civile; Skenderaj, 16 prill 1999, 13 viktima civile; Mitrovicë, 16 prill 1999, 9 viktima civile; Çikatovë e Vjetër, 17 prill 1999, 128 viktima civile; Paklek i Vjetër, 17 prill 1999, 41 viktima civile; Hade (Obiliq), 17-18 prill 1999, 10 viktima civile, disa i djegin të gjallë; Ribari i Vogël, 18 prill 1999, 25 viktima civile; Devë (Gjakovë), 18 prill 1999, 7 viktima civile, familja Bobi; Bërrnicë e Epërme, 18 prill 1999, 6 viktima civile; Hallaq i Vogël, 19 prill 1999, 20 viktima civile; Makoc, 20 prill 1999, 42 viktima civile; Grashticë, 21 prill 1999, 60 viktima civile; Nakaradë e Fushë Kosovës, 21 Prill 1999, 16 viktima civile, anëtarë të familjes Mirena; Dragaçinë (Suharekë), 21 prill 1999, 11 viktima civile, pleq që u hodhën në pus të gjallë; Koliq, 22 Prill 1999, 21 viktima civile; Mejë dhe Korenicë, 27 Prill 1999, rrreth 500 viktima civile të ndarë nga kolona që depërtohej në Shqipëri; Guskë, 27 prill 1999, 25 viktima civile; Dobrosh, 27 prill 1999, 38 viktima civile; Korenicë, 27 prill 1999, 65 viktima civile; Nabërxhan, 1,2,10 dhe 12 maj 1999, 30 viktima civile; Studime, 2 maj 1999, 116 viktima civile; Bukosh, 3 maj 1999, 35 viktima civile; Pejë, 12 maj 1999, 7 viktima civile nga familja Bala; Korishë, 13 maj 1999, 71 viktima civile, si rezultat i përdorimit të popullatës civile si mburojë ndaj bombardimit të NATO-s nga forcat serbe; Qyshk, Pavlan dhe Zahaq (Pejë), 14 maj 1999, 77 viktima civile; Carrallukë, 17 maj 1999, 23 viktima civile, anëtarë të dy familjeve Krasniqi; Burgu i Dubravës, 21 e 22 maj 1999, 97 të burgosur të ekzekutuar e masakruar; Vushtrri, 22 maj 1999, 68 viktima civile; Vushtrri, 24 maj 1999, 8 vajza të mitura; Lagja Tusus (Prizren), 26 maj 1999, 27 viktima civile dhe 247 shtëpi të djegura; Familja Gérxhaliu, 31 maj 1999, 12 viktima civile; Mitrovicë, 8 qershor 1999, 9 viktima civile të zhdukura, disa të djegura; Familja Bala në Pejë, 12 qershor 1999, 7 viktima civile, prej tyre 5 fëmijë të mitur; etj.;¹ Vërbovc dhe Shtuticë, 30 prill 1999, 275 viktima civile; Pokleku i Ri, 17 prill 1999, 53 viktima civile; 27 mars 1999 Dardania I dhe II (Brezhaniku I dhe II) Pejë 46 viktima civile!

- gjatë luftës së viteve 1998-1999 në Kosovë forcat e RFJ (Serbia dhe Mali i Zi), sidomos të Serbisë ushtruan dhunë seksuale ndaj rrreth 20 mijë personave, kryesisht gra e vajza shqiptare, të cilat kanë përjetuar vuajtje të mëdha, traumatizim të rëndë dhe plagë të pashlyera psikologjike;
- gjatë luftës së viteve 1998-1999 në Kosovë, forcat e armatosura të RFJ (Serbia dhe Mali i Zi), sidomos të Serbisë dëbuan nga shtëpitë e tyre mbi 1 milion persona civilë të të gjitha etnive, kryesisht shqiptarë, në të shumtën e rasteve duke konfiskuar çdo dokument identifikimi personal, dokumente të automjeteve dhe çfarëdo dokumenti tjetër, me qëllim të shkatërrimit të dëshmive për identitetin e tyre dhe përkatësinë shtetërore;

¹ Agjencia shtetërore e Arkivave të Kosovës, Krimet e Serbisë në Kosovë 1998-1999, Libri 2, ed. Osman, Jusuf, Prishtinë 2010, f. 49-57. Lista e masakrave të tillë nuk është shteruese, për shkak se ende nuk janë mbledhur të gjitha të dhënat nga terreni. Sidomos numri i viktimave është më i madh se shifrat e pasqyrura në këtë tekst.

- në funksion të fshehjes së krimit dhe të shmangies nga përgjegjësia e drejtpërdrejtë në kryerjen e gjenocidit, institucionet shtetërore të RFJ (Serbia dhe Mali i Zi), sidomos të Serbisë, zhvendosën me forcë në territorin e Serbisë mijëra civilë shqiptarë të të gjitha moshave, të gjallë dhe të vrarë;
 - përveç një numri të caktuar që u kthyen të gjallë pas përfundimit të luftës, pasi kishin përjetuar trajtime çnjerëzore nëpër burgjet e Serbisë, mijëra kufoma civilësh shqiptarë, të masakruar, të varrosur e të zhvarrosur dhe të rivarrosur, për të humbur gjurmët e krimit, janë gjetur në varreza masive anembanë Serbisë;
 - edhe 20 vjet pas përfundimit të luftës në Kosovë, shteti Serb vazhdon të fshehë të vërtetën përfundimit të luftës, pasi kishin përfunduar 1600 personave, të cilët vazhdojnë të mbeten të zhdukur me forcë gjatë luftës në Kosovë;
 - duke ndjekur parimin e ‘tokës së djegur’, me qëllim të shkatërrimit të bazës ekonomike, zhdukjes së kujtesës historike, zhdukjes së bazës njerëzore përfundimit të luftës, forcat e armatosura të RFJ (Serbia dhe Mali i Zi), sidomos ato serbe, shkatërruan 100'389 objekte banimi, 88'101 objekte përcjellëse, 358 ndërtesa shkollore të shkatërruara tërësisht apo pjesërisht nga gjithsejtë rreth 700, 215 objekte fetare (xhami, tyrbe, teqe dhe kisha katolike), 123 objekte shëndetësore, dhe mbi 190 shtëpi kulture, biblioteka dhe ndërtesa administrative, etj.²

Duke riku jtuar se:

- Gjykata Penale Ndërkombëtare për Ruandën i cilësoi dhe i dënoi dhunimet seksuale ndëretnike si akte gjenocidi, për shkak të faktit se dhunimi paraqet cenim të rëndë të integritetit fizik dhe mendor të viktimit;³
 - Neni II paragrafi (b) i Konventës për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit cilëson si forma të gjenocidit edhe cenimin e rëndë të integritetit fizik ose mendor;
 - krimi i gjenocidit, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës, si krime tejet të rënda që godasin tërë komunitetin ndërkombëtar, nuk vjetërsohen kurrë dhe si të tilla nuk mund të mbisin të pandëshkuara;
 - është obligim i çdo shteti që t'i sjellë para drejtësisë të gjithë kriminelët dhe përgjegjësit e kimeve ndërkombëtare;
 - Kuvendi i Republikës së Kosovës duke hedhur poshtë si të papranueshme të gjitha marrëveshjet politike që janë bërë mes Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-

² Agjencia shtetërore e Arkivave të Kosovës, Krimet e Serbisë në Kosovë 1998-1999, Libri 2, ed. Osman, Jusuf, Prishtinë 2010, f. 469.

³ Trial Chamber I of the ICTR e ka definuar përdhunimin si "invasion fizik të natyrës seksuale, të kryer ndaj një personi në rrethanat shtërnguese." Prosecutor v. Akayesu, Case No. ICTR-96-4-T, Judgment, P 598 (Sept. 2, 1998) [hereinafter Akayesu Judgment].

Jugosllavinë dhe Qeverisë së Serbisë, për të ndryshuar kualifikimin e dhunimeve seksuale si një nga elementet konstitutive të krimit të gjenocidit.

Konstaton se:

- se vrasjet e fëmijëve, e grave, e të moshuarve, e personave civilë në përgjithësi, kryesisht shqiptarë, gjatë luftës së viteve 1998-1999 në Kosovë përbën krim të gjenocidit në kuptimin e përkufizimit të gjenocidit në Konventën për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit;
- dëbimi i shqiptarëve dhe spastrimi etnik i Kosovës përbën krim të gjenocidit dhe shkelje të rëndë të Konventës për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit;
- zhdukja me dhunë e civilëve shqiptarë përbën krim kundër njerëzimit dhe shkelje të rëndë të Deklaratës së Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e personave nga zhdukja me dhunë;
- dhuna seksuale në konfliktet e armatosura, pra luftë, përbën krim të gjenocidit në kuptimin si përkufizohet gjenocidi me Konventën për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit;
- pas përfundimit të luftës në Kosovë nuk është bërë asnjë dënim politik i kimeve të luftës, kimeve kundër njerëzimit dhe krimit të gjenocidit të kryer nga regjimi serb në Kosovë, derisa institucionet politike dhe të drejtësisë në Serbi vazhdojnë të mohojnë krimin e gjenocidit në Kosovë dhe, rrjedhimisht, refuzojnë riparimin e dëmeve të shkaktuara;
- krimet sistematike të kryera nga regjimi serb janë bërë me qëllim të shfarosjes së popullit shqiptar në Kosovë, prandaj përbëjnë krim të gjenocidit;
- pranimi i krimit të gjenocidit kundër shqiptarëve në Kosovë përbën një akt thellësisht humanitar, që lehtëson përballimin e dhembjes për të mbijetuarit e gjenocidit dhe nderon kujtimin e viktimave të gjenocidit.

Duke rikujtuar se:

- Më 15 janar 1999 forcat serbe kryen aktin gjenocidar në Reçak, gjatë të cilit u masakruan 42 civilë shqiptarë;
- ky akt monstruoz mobilizoi komunitetin ndërkombëtar për t'i dhënë fund politikës së gjenocidit në Kosovë dhe, për këtë qëllim organizoi Konferencën Ndërkombëtare për Kosovën në Rambuje;
- faktin që regjimi serb refuzoi zgjidhjen paqësore të Çështjes së Kosovës dhe vazhdoi politikën e gjenocidit kundër shqiptarëve në Kosovë;

- ndërhyrjen ushtarake të NATO-s për t'i dhënë fund krimit të gjenocidit ndaj shqiptarëve në Kosovë dhe për të ndaluar krizën e madhe humanitare të shkaktuar nga forcat e RFJ (Serbia dhe Mali i Zi), sidomos Serbia;
- Kuvendi i Kosovës shpallë 15 Janarin Ditë të Përkujtimit të Gjenocidit ndaj Shqiptarëve në Kosovë.

Kërkon nga shteti i Serbisë:

- të pranojë faktin se ky shtet, në kundërshtim të plotë me Konventën për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit, të datës 9 dhjetor 1948 dhe duke shkelur rëndë Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949 dhe të Protokolleve shtesë të këtyre konventave, ka kryer krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe gjenocid në Kosovë, në periudhën 1998-1999;
- të ndriçojë plotësisht fatin e të gjithë atyre që ende konsiderohen të zhdukur dhe të pagjetur nga forcat e RFJ (Serbia dhe Mali i Zi), sidomos Serbia, gjatë luftës në Kosovë 1998-1999, por edhe më herët;
- të sjellë para drejtësisë përgjegjësit e krimit të gjenocidit, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës në Kosovë 1998-1999;
- të riparojë ato dëme të gjenocidit, të krimet kundër njerëzimit dhe të krimet e luftës, që ende mund të riparohen;
- shpreh vendosmërinë e vet që, përmes masave në nivel kombëtar dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar, të sigurohet ndëshkimi i atyre që kanë planifikuar, kanë kryer apo kanë nxitur të kryhet gjenocidi, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës në Kosovë 1998-1999;
- të paguajë dëmshpérblim, duke bërë kompensimin e të gjitha shkatërrimeve dhe dëmeve në infrastrukturë materiale në Kosovë.

Kuvendi i Kosovës:

- Duke pasur parasysh faktin se mohimi i krimit të gjenocidit, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës konsiderohet si fyerje më e rëndë që mund t'u bëhet viktimate të këtyre krimet, familjarëve të tyre dhe tërë kombit ndaj të cilit është ushtruar gjenocidi, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës;
- duke u nisur nga fakti se informimi i drejtë dhe i gjithanshëm është kusht i domosdoshëm kundër negacionizmit, si tërësi e qëndrimeve dhe e shpjegimeve të dhëna për të mohuar dhe shkatëruar vërtetësinë e gjenocidit në Kosovë të kryer nga forcat e RFJ (Serbia dhe Mali i Zi), sidomos Serbia në periudhën e Luftës 1998-1999;

- kërkon nga të gjitha institucionet politike dhe shkencore të Kosovës, që të angazhohen maksimalisht për ndriçimin e tërësishëm të gjenocidit në Kosovë dhe të sigurojë përkrahjen politike për njohjen e faktit që shqiptarët e Kosovës ishin viktima të gjenocidit;
- duke rikujtuar me shqetësim se përpjekjet për të mohuar apo për të arsyetuar krimin e gjenocidit, siç është definuar në Konventë dhe është etabluar si i tillë sipas të drejtës ndërkombëtare, mund të rrezikojnë dhe minojnë luftën kundër mosndëshkimit, pajtimit dhe përpjekjeve për të parandaluar gjenocidin,⁴ ndërmerr nismën për përfshirjen në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, si vepër penale lejimin, arsyetimin, mohimin, minimizimin e gjenocidit, krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit, të kryera në Kosovë nga forcat serbe ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë.

Nr. 06-R-017

Prishtinë, më 16 maj 2019

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Rezoluta u dërgohet:



- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Arkivit të Kuvendit.

⁴ Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB: A/HRC/RES/37/26, 23 mars 2018, për parandalimin e ktimit të gjenocidit.